



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 38, Datë 23.02.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
PËR NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 113, DATË 08.07.2016.**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.02.2018, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se :

- Bordi i ERE me vendimin nr.113 datë 08.07.2016 ka vendosur të miratojë “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”.
- Në datë 06.02.2018 në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë OSHEE sh.a. me nr. 2312, Prot., (Protokolluar në ERE me nr. 171, datë 12.02.2018,) nëpërmjet së cilës OSHEE sh.a. kërkon nga ERE amendimin e dispozitave të kësaj rregulloreje që kanë të bëjnë me lejjimin e abonentëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a., për disa ndryshime në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 113, datë 08.07.2016, si më poshtë:
 - a. *Lejjimin e klientëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin në rast se debia merret përsipër nga furnizuesi i ri;*

b. Lejimin e klientëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin në rast se midis furnizuesit të mëparshëm dhe klientit ka një marrëveshje për likuidim të vonuar të debisë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît AHMETI